

VENDIM
Nr. 273, datë 2.5.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE Ë PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘SUL MISIRI’”, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Sul Misiri’”, Bashkia Elbasan.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.
 3. Pronarët e pasurisë të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 15 m², me vlerë të përgjithshme prej 519 660 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 519 660 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj, me vendim të këshillit bashkiak.
 5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Bashkisë Elbasan certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit, si dhe kartelën e pasurisë.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Elbasan.
 9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.
 10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘SUL MISIRI’”, BASHKIA ELBASAN**

			Vërtetim pronësie			Truall			Ndërtesa				“Njësi”				SHPRONËSIM I	Vërejtje
Nr .	Familja që shpronësohet	Nr.	m²			shpron .	çmimi	shpronësi m	sip. ndërtesës m²	çmimi	shpronësi m	sip. njësisë m²	çmimi	shpronësi m	SHUMA			
1	Liljana Sefer Musaj, Merita Sefer Musaj, Vera Sefer Musaj	Pas.	trual l	banesë	njës i	m2	lek/m 2	lekë	preke t	shpro.	lek/m 2	lekë	preke t	shpro .	lek/m 2	lekë	leke	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		9/159	0.00	15.00	0.00	0.00	12764	0.00	15.00	15.00	34644	519660.00	0.00	0.00	62686	0.00	519660.00	
					0.00	0.00		0.00	519660.00				0.00		0.00	519660.00		